



Sheshi Nënë Terezë, Hyrja. I · 59A · Nr. 10  
Prishtinë, 10000  
Republika e Kosovës  
T/F: +381 38 746 206  
**E-mail:** ridea.institute@gmail.com  
**Website:** www.ridea-ks.org

## **STUDIM:**

# **ANËTARËSIMI EVENTUAL I KOSOVËS NË ORGANIZATËN E TRAKTATIT TË ATLANTIKUT TË VERIUT (NATO): PROCEDURAT DHE PERSPEKTIVAT**

Nëntor 2019

## STUDIM:

# ANËTARËSIMI EVENTUAL I KOSOVËS NË ORGANIZATËN E TRAKTATIT TË ATLANTIKUT TË VERIUT (NATO): PROCEDURAT DHE PERSPEKTIVAT

Ky studim u mbështet nga:



Norwegian Embassy

**Deklaratë mohimi:** Pikëpamjet dhe analiza në këtë raport janë vetëm të RIDEA-s dhe nuk pasqyrojnë pikëpamjet e donatorit.

**Autor:** Instituti Kërkimor për Çështje Evropiane dhe të Zhvillimit (RIDEA)

Nëntor 2019

## Përmbajtja

Shkurtesat.....	i
Hyrje.....	1
Një historik i shkurtër i përfshirjes së NATO-s në Kosovë .....	2
Kriteret e anëtarësimit të NATO-s dhe zgjerimi i saj pas Luftës së Ftohtë.....	7
Kosova dhe NATO: Një 'fëmijë' i NATO-s që trajtohet si i flakur .....	14
Përvoja e vendeve të rajonit dhe 'mësimet e nxjerra' për Kosovën .....	21
Përfundime .....	25
Rekomandime .....	28

## Shkurtesat

<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>FSK</b>	Forca e Sigurisë së Kosovës
<b>IMP</b>	Prania Ushtarake Ndërkombëtare
<b>ISSR</b>	Rishikimi i Sektorit të Sigurisë së Brendshme
<b>MAP</b>	Plani i Veprimit për Anëtarësim
<b>NALT</b>	Ekipi Këshillues dhe Ndërlidhës
<b>NAT</b>	Ekipi Këshillues i NATO-s
<b>NATO</b>	Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut
<b>OKB</b>	Organizata e Kombeve të Bashkuara
<b>PfP</b>	Partneriteti për Paqe
<b>RFJ</b>	Republika Federale e Jugosllavisë
<b>SSSR</b>	Rishikim i Sektorit të Sigurisë Strategjike
<b>SOFA</b>	Marrëveshja e Statusit të Forcave
<b>SHBA</b>	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
<b>TMK</b>	Trupat e Mbrojtjes së Kosovës
<b>UÇK</b>	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
<b>UNMIK</b>	Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

## Hyrje

1. Historia e kohëve të fundit e Kosovës ndërthuret me rolin e Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO) për të garantuar paqen dhe sigurinë në Evropë. Vendimi i NATO-s për të filluar Operacionin Forca Aleate në 24 mars 1999, ishte i dobishëm jo vetëm për të ndaluar shtypjen e shqiptarëve të Kosovës nga regjimi i Millosheviçit, por, më e rëndësishmja, për të vendosur në lëvizje një proces ushtarak, diplomatik dhe politik që, së pari, çliroi Kosovën nga sundimi serb dhe më pas krijoi rrethanat për formimin e institucioneve të reja të vetëqeverisjes nën kujdesin e Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK). Pothuajse një dekadë më vonë, në vitin 2008, Kosova shpalli pavarësinë e saj duke zyrtarizuar ekzistencën e saj të pavarur si shteti më i ri në Evropë.
2. Ndërsa procesi politik rreth statusit të Kosovës ka përparuar ndjeshëm në njëzet vitet e fundit me të gjitha kthesat e tij, mandati i NATO-s ka mbetur në thelb i njëjtë që nga viti 1999. Mandati i saj buron nga Marrëveshja Teknike Ushtarake midis Forcës Ndërkombëtare të Sigurisë (KFOR) dhe Qeverisë së Republikës Federale të Jugosllavisë dhe Republikës së Serbisë (Marrëveshja e Kumanovës) dhe Rezoluta 1244 e OKB-së.
3. Duke pasur parasysh pamundësinë e fuqive perëndimore për të zëvendësuar Rezolutën 1244 ose për të siguruar që Kosova të fitojë anëtarësimin në OKB, prania e NATO-s në Kosovë (KFOR), është dashur të adaptojë rolin e saj bazuar në ndryshimet në terren dhe pa ndryshuar zyrtarisht misionin origjinal. Sidoqoftë, megjithë ndikimin pozitiv të pranisë së NATO-s në Kosovë, mosmarrëveshjet e vazhdueshme për statusin e Kosovës kanë krijuar pengesa të ndryshme ligjore dhe politike në marrëdhëniet e Kosovës me KFOR-in, si dhe marrëdhëniet e saj me NATO-n. Mbi të gjitha, ajo ka ndërlikuar perspektivat e anëtarësimit në NATO në të ardhmen e parashikueshme.
4. Ky punim paraqet një analizë juridike dhe politike të: së pari, përfshirjes dhe mandatit të NATO-s në Kosovë; së dyti, historisë së zgjerimit të NATO-s pas përfundimit të Luftës së Ftohtë me qëllim të nënvizimit të kritereve kryesore të

anëtarësimin dhe ofrimin të një përmbledhje të shembujve përkatës nga rajoni; së treti, përpjekjeve të Kosovës për të krijuar strukturat e saj të sigurisë dhe të përafrohen me NATO-n. Punimi do të përfundojë me një diskutim të opsioneve dhe rekomandimeve të politikave.

## **Një historik i shkurtër i përfshirjes së NATO-s në Kosovë**

5. NATO ka udhëhequr një operacion për përkrahjen e paqes në Kosovë - Forcën e Kosovës (KFOR) - që nga qershori 1999. KFOR u krijua në vijim të fushatës 78-ditore të NATO-s kundër regjimit të Millosheviçit, me qëllim që t'i jepte fund dhunës në Kosovës. Mandatin i tij rrjedh nga Rezoluta 1244 (1999) e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe Marrëveshjes Tekniko-Ushtarake midis NATO-s, Republikës Federale të Jugosllavisë dhe Serbisë. Sipas nenit 4, aneksit 2, të Rezolutës 1244 të OKB, "Prania ndërkombëtare e sigurisë me pjesëmarrje të konsiderueshme të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut duhet të vendoset nën komandën dhe kontrollin e unifikuar dhe të autorizohet të krijojë një mjedis të sigurt për të gjithë njerëzit në Kosovë dhe të lehtësojë kthimin e sigurt në shtëpitë e tyre për të gjithë personat e zhvendosur dhe refugjatët."
6. KFOR-i operon nën Kapitullin VII të Kartës së OKB-së dhe, si i tillë, është një operacion i zbatimit të paqes. Objektivat origjinale ishin të shmangin armiqësitë e përtërira, të krijojnë një mjedis të sigurt dhe të sigurojnë rendin dhe sigurinë publike, demilitarizimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), mbështetjen e përpjekjes ndërkombëtare humanitare dhe koordinimin me praninë ndërkombëtare civile. Njëzet vjet nga vendosja e tij, KFOR-i vazhdon të kontribuojë në mirëmbajtjen e një mjedisi të sigurt në Kosovë dhe garantimin e lirisë së lëvizjes për të gjithë në përputhje me mandatin e tij origjinal.<sup>1</sup>
7. Në vitin 1999, KFOR-i përbëhej nga më shumë se 50,000 trupa që vepronin nën një zinxhir të vetëm të komandës/autoritetit të Komandantit të KFOR-it (COMKFOR) i cili raporton te Komandanti i Komandës së Forcave të Përbashkëta

---

<sup>1</sup> NATO (2018), 'Roli i NATO-s në Kosovë.' E disponueshme: [https://www.nato.int/cps/en/natolive/topics\\_48818.htm#](https://www.nato.int/cps/en/natolive/topics_48818.htm#) [Qasur më: 22 tetor, 2019].

në Napoli, Itali. Me kalimin e kohës dhe me përmirësimin e situatës së sigurisë, NATO-ja gradualisht ka transformuar KFOR-in drejt një force më të vogël dhe më fleksibël me më pak detyra statike. Sot, KFOR përbëhet nga afro 4,000 trupa nga 28 vende të ndryshme. Ai vazhdon të ndihmojë në mirëmbajtjen e një mjedisi të sigurt dhe garantimin e lirisë së lëvizjes për të gjithë njerëzit dhe komunitetet në Kosovë, sipas mandatit të tij origjinal.

8. Përveç misionit kryesor për sigurimin e një mjedisi të sigurt në Kosovë, KFOR ka luajtur një rol jetik në krijimin e strukturave të sigurisë së Kosovës. Për këtë qëllim, KFOR ka luajtur një rol të rëndësishëm në mbështetjen e Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK), të themeluara në procesin e demilitarizimit dhe transformimit të UÇK-së, si dhe Shërbimit Policor të Kosovës. Në veçanti, NATO dhe misioni i saj paqeruajtës në Kosovë u përfshinë në trajnime dhe mbikëqyrje të përditshme të TMK-së.
9. Në vitin 2005, filloi procesi i Rishikimit të Sektorit të Sigurisë së Brendshme (ISSR), i cili kishte për qëllim të vlerësojë dizajnin institucional, të forcojë pronësinë lokale dhe të propozojë arkitekturën e re të sigurisë brenda Kosovës. Kjo hapi rrugën për një proces të transferimit gradual të kompetencave në fushën e sigurisë tek institucionet vendore. Më e rëndësishmja, ISSR rekomandoi një forcë të vogël mbrojtëse prej jo më shumë se 2.500 personave që do të trashëgojnë funksionet e kryera nga TMK-ja. Forca mbrojtëse duhej të rekrutohej nga e gjithë popullata pa dallime etnike dhe pa kufizime për anëtarët e TMK-së që aplikonin për poste individualisht - por po ashtu pa të drejta për poste për anëtarët e TMK-së.<sup>2</sup>
10. Deklarata e Pavarësisë së Kosovës në vitin 2008 paraqet një pikë kthese në marrëdhëniet aktuale midis Kosovës dhe KFOR-it. Ndërsa nga njëra anë, mandati i KFOR-it mbetet i njëjtë në përputhje me Rezolutën 1244, që do të thotë gjithashtu se NATO-ja ka qëndrim neutral në raport me statusin e Kosovës, në praktikë, ajo ndërmoi një numër masash për t'iu përshtatur realitetit të ri. Kjo përfshinte edhe

---

<sup>2</sup> Yll Bajraktari dhe Christina Parajon (2006) 'The Future of Kosovo's Security Sector.' E disponueshme: <https://www.usip.org/publications/2006/12/future-kosovos-security-sector> [Qasur më: 22 tetor 2019].

transferimin e detyrave të sigurisë tek institucionet e reja të sigurisë së Kosovës (policia) por edhe detyra shtesë për ndërtimin e kapaciteteve në lidhje me Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK) të sapokrijuar.

- 11.** Sa i përket çështjes së pozicionit të NATO-s përballë statusit të Kosovës, në dhjetor 2007, ministrat e jashtëm të NATO-s ranë dakord që KFOR-i të mbetet në Kosovë në bazë të Rezolutës 1244, përveç nëse Këshilli i Sigurimit vendos ndryshe. Në Samitin e Bukureshtit në Prill 2008, udhëheqësit e NATO-s ranë dakord që NATO dhe KFOR do të vazhdojnë të punojnë me autoritetet lokale. Ata gjithashtu ranë dakord që, duke pasur parasysh mandatin e tij operacional, KFOR do të bashkëpunonte dhe ndihmonte Kombet e Bashkuara, Bashkimin Evropian dhe akterë të tjerë ndërkombëtarë, sipas rastit, për të mbështetur zhvillimin e një Kosove të qëndrueshme, demokratike, multi-etnike dhe paqësore.
- 12.** Po kështu, Ministrat e Jashtëm të NATO-s, më 2-3 dhjetor 2008, riafirmuan që prania e KFOR-it, e udhëhequr nga OKB, do të mbetet në Kosovë në bazë të Rezolutës 1244 të OKB-së. Ata ripohuan që NATO do të vazhdojë të punojë drejt shuarjes së Trupave Mbrojtëse të Kosovës dhe krijimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës në bazë të fondeve të besimit vullnetar të NATO-s.<sup>3</sup>
- 13.** Ndërsa situata e sigurisë vazhdoi të përmirësohet, NATO vazhdoi me zbatimin e të ashtuquajturit process i shkëputjes: transferimin gradual të sigurisë për vendet e trashëgimisë fetare dhe kulturore nën mbrojtjen e KFOR-it të Policia e Kosovës. Kështu, deri në fund të 2013-ës, KFOR-i kishte transferuar sigurinë për tetë prona me status të veçantë të përcaktuar: Monumentin e Gazimestanit, Manastirin e Graçanicës, Manastirin e Zocishtes, Manastirin e Budisavcit, Manastirin e Goriocit, Zonën e Arckangjelit, Manastirin e Devicit dhe Patriarkanën e Pejës. Vetëm një vend i caktuar - Manastiri i Deçanit - aktualisht mbetet nën mbrojtje fikse të KFOR-it.<sup>4</sup> Në mënyrë të ngjashme, KFOR-i gradualisht ka transferuar përgjegjësinë e

---

<sup>3</sup> KFOR (2019), 'Historia'. E disponueshme: <https://jfcnaples.nato.int/kfor/about-us/history> [Qasur më: 22 tetor 2019].

<sup>4</sup> NATO (2018) NATO's Role in Kosovo. E disponueshme: [https://www.nato.int/cps/en/natolive/topics\\_48818.htm#](https://www.nato.int/cps/en/natolive/topics_48818.htm#) [Qasur më: 22 tetor 2019].



kontrollit kufitar (me Shqipërinë, Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut) te Policia e Kosovës.

- 14.** Sa i përket detyrave për ndërtimin e kapaciteteve, më 12 qershor 2008, NATO ra dakord të fillojë zbatimin e detyrave shtesë në Kosovë, d.m.th. të ndihmojë në shpërbërjen e Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) dhe në krijimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), si dhe një strukturë civile për të mbikëqyrur FSK-në. Detyrat e mëposhtme janë zbatuar në koordinim dhe konsultim të ngushtë me autoritetet përkatëse vendore dhe ndërkombëtare.
- 15.** Roli i vazhdueshëm i NATO-s në Kosovë është përfshirë në Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës (Propozimi i Ahtisarit). Sipas nenit 13 (Prania Ushtarake Ndërkombëtare) të Propozimit, “NATO do të krijojë një Prani Ushtarake Ndërkombëtare (IMP) për të mbështetur zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, siç përcaktohet në Aneksin XI të saj.” Përveç rolit të saj në sigurimin e zbatimit të këtij Propozimi, IMP është gjithashtu përgjegjës për sigurimin e një mjedisi të sigurt në të gjithë territorin e Kosovës deri në kohën kur institucionet e Kosovës janë në gjendje të marrin përsipër përgjegjësi. Propozimi gjithashtu parashikoi zhvillimin e një procesi për të siguruar një plan tranzicioni për dorëzimin e përgjegjësisë të sigurisë së IMP me kalimin e kohës.
- 16.** Megjithatë, duke pasur parasysh pamundësinë e Këshillit të Sigurimit për të miratuar Propozimin e Ahtisarit, një transferim i plotë i përgjegjësisë për sigurinë në institucionet e Kosovës shtyhet për një kohë të pacaktuar. Sidoqoftë, kjo nuk e ka penguar NATO-n të ushtrojë përgjegjësinë e saj për zhvillimin e FSK-së. Që nga viti 2008, NATO ka mbikëqyrur ngritjen dhe trajnimin e një FSK-je shumë-etnike, profesionale dhe nën mbikëqyrje civile.
- 17.** Ndërtimi i kapaciteteve të NATO-s në Kosovë ushtrohet përmes Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës (NALT), i cili arriti aftësinë e plotë operacionale në janar 2017. Ky ekip u krijua pas bashkimit të Ekipit Ndërlidhës dhe Këshillit të NATO-s (NLAT), që vazhdoi të mbështes FSK-në përtej deklaratës së Këshillit të Atlantikut të Veriut për arritjen e kapaciteteve të plota operacionale të FSK-së në korrik 2013; dhe

Ekipi Këshillues i NATO-s (NAT), i krijuar në vitin 2008 për të mbikëqyrur krijimin e një organizate të udhëhequr nga autoritetet civile të Kosovës për të ushtruar kontroll civil mbi FSK-në.

**18.** NALT është një ekip me 41 personel ushtarak dhe civil, i ardhur nga 13 vende aleate dhe partnere. Ekipi ofron ndihmë praktike dhe këshilla për organizatat e sigurisë në Kosovë nga ekzekutivi deri në nivelin e forcës në fusha të tilla si logjistika, prokurimi dhe financat, zhvillimi dhe planifikimi i forcave, si dhe zhvillimi i lidershit. NALT gjithashtu luan një rol kryesor në zbatimin e ndërveprimit të zgjeruar me Kosovën që u miratua nga Këshilli i Atlantikut të Veriut në Dhjetor 2016.<sup>5</sup>

**19.** Pra, në Kosovën e pavarur, roli i NATO-s është i dyfishtë: së pari, ajo vazhdoi të angazhohet në mbështetjen e përpjekjeve për ndërtimin e kapaciteteve në lidhje me FSK-në dhe, së dyti, vazhdon të sigurojë një mjedis të qetë dhe të sigurt për të gjithë njerëzit dhe komunitetet në Kosovë sipas mandatit të saj nga Kombet e Bashkuara derisa të krijohen kushte për një transferim të plotë të kompetencave të institucionet vendore. Për këtë qëllim, NATO dhe KFOR kanë mbështetur në mënyrë aktive dialogun e Brukselit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

**20.** Sidoqoftë, çështjet politike kanë vazhduar të jenë një gjembaç në marrëdhëniet e Kosovës me NATO-n. Kjo më së miri manifestohet në rastin e shndërrimit të FSK-së nga një forcë mbrojtëse civile në ushtri. Megjithëse në korrik 2013 Këshilli i Atlantikut të Veriut deklaroi se Forca e Sigurisë së Kosovës ka arritur aftësinë e plotë operacionale dhe është plotësisht e aftë të kryejë detyrat që i janë caktuar brenda mandatit të saj dhe sipas standardeve të përcaktuara nga NATO, procesi i transformimit është vonuar për pesë vjet për shkak të mosmarrëveshjeve në lidhje me rrugën ligjore që duhet ndjekur në procesin e transformimit.

**21.** Qëndrimi i NATO-s ka qenë se procesi i transformimit duhet të ndodhë vetëm përmes ndryshimeve kushtetuese, që në praktikë nënkupton pëlqimin e

---

<sup>5</sup> Po aty.

deputetëve serbë në Parlamentin e Kosovës. Në një situatë kur partia kryesore serbe, Srpska Lista (Lista Serbe) kontrollohet drejtpërdrejt nga Qeveria serbe, një zgjidhje e tillë doli praktikisht e pamundur.

**22.** Megjithë rezervat e NATO-s, Parlamenti i Kosovës votoi në dhjetor 2018 për të ndryshuar mandatin e FSK-së duke ruajtur emrin e saj. Megjithë mbështetjen e SHBA-ve, NATO reagoi duke përmendur shqetësime për 'kohën e keqe' të vendimit. Sipas Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg, "NATO mbështet zhvillimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës nën mandatin e saj aktual. Me ndryshimin e mandatit, Këshilli i Atlantikut të Veriut tani do të duhet të rishqyrtojë nivelin e angazhimit të NATO-s me Forcën e Sigurisë së Kosovës."<sup>6</sup>

**23.** Sidoqoftë, krijimi i FSK-së si një forcë e armatosur me një mandat të ri është një ngjarje historike në procesin e përfundimit të arkitekturës së sigurisë në Kosovë dhe konsolidimit të shtetësisë. Ky vendim hap horizonte të reja për Kosovën në bashkëpunimin e saj ushtarak me NATO-n dhe vendet e saj anëtare individuale me qëllim të anëtarësimit në Aleancë në të ardhmen e afërt. Megjithatë, para se të vlerësojmë gatishmërinë e Kosovës për t'u anëtarësuar në NATO, ne do të përshkruajmë shkurtimisht procesin e anëtarësimit në NATO dhe kërkesat politike dhe ushtarake që dalin nga ky proces.

## **Kriteret e anëtarësimit të NATO-s dhe zgjerimi i saj pas Luftës së Ftohtë**

**24.** Që nga themelimi në vitin 1949, Aleanca e NATO-s është rritur nga 12 në 29 vende përmes shtatë raundeve të zgjerimit. Si aleancë e mbrojtjes kolektive, qëllimi i NATO-s është të garantojë lirinë dhe sigurinë e anëtarëve të saj me mjete politike dhe ushtarake. NATO gjithashtu promovon vlera demokratike dhe u mundëson anëtarëve të konsultohen dhe bashkëpunojnë në çështjet e mbrojtjes dhe të

---

<sup>6</sup> NATO (2018), 'Deklaratë e Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s për miratimin e ligjeve për tranzicionin e Forcës së Sigurisë së Kosovës'. E disponueshme: [https://www.nato.int/cps/en/natohq/news\\_161631.htm](https://www.nato.int/cps/en/natohq/news_161631.htm) [Qasur më: 22 tetor 2019].

lidhura me sigurinë për të zgjidhur problemet, të krijojnë besim dhe, në planin afatgjatë, të parandalojnë konfliktin.

**25.** Dera e NATO-s mbetet e hapur për çdo vend evropian që është në gjendje të ndër marrë angazhimet dhe detyrimet e anëtarësimit, dhe të kontribuojë në sigurinë në zonën Euro-Atlantike. Në terma konkret, anëtarësimi në NATO mbetet i hapur për “çdo shtet tjetër evropian në gjendje të çojë më tej parimet e këtij Traktati dhe të kontribuojë në sigurinë e zonës së Atlantikut të Veriut.” Aktualisht, NATO ka 29 anëtarë dhe katër vende partnere kanë deklaruar aspiratat për anëtarësim në NATO: Bosnje dhe Hercegovina, Gjeorgjia, Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Ukraina.

**26.** Vendet që kanë shprehur interes për t'u anëtarësuar në Aleancë fillimisht janë të ftuara të përfshihen në një Dialog të Intensifikuar me NATO-n në lidhje me aspiratat e anëtarësimit të tyre dhe reformat që lidhen me të. Përveç që duhet të dëshmojnë se ato janë në gjendje të çojnë më tej parimet e Traktatit të Uashingtonit të vitit 1949 dhe të kontribuojnë për sigurinë në zonën euro-atlantike, vendet aspiruese duhet të plotësojnë disa kriteret politike, ekonomike dhe ushtarake, të cilat janë përcaktuar në Studimin e vitit 1995 për Zgjerimin e NATO-s.

**27.** Studimi i vitit 1995 për Zgjerimin e NATO-s është një studim i kryer për të analizuar meritat e pranimit të anëtarëve të rinj dhe mënyrën sesi ato duhet të sillen në dritën e mundësive të dhëna nga fundi i Luftës së Ftohtë për të garantuar siguri shtesë në të gjithë zonën Euro-Atlantike. Ky studim gjithashtu diskuton mënyrat me të cilat zgjerimi i NATO-s do të kontribuonte në forcimin e stabilitetit dhe sigurisë për të gjithë.

**28.** Sipas Studimit, vendet që kërkojnë anëtarësimin në NATO do të duhet të jenë në gjendje të demonstrojnë se kanë përmbushur disa kërkesa. Këto përfshijnë: një sistem politik demokratik që funksionon bazuar në një ekonomi të tregut; trajtimi i drejtë i popullatës pakicë; një angazhim për zgjidhjen paqësore të konflikteve; aftësia dhe gatishmëria për të dhënë një kontribut ushtarak në operacionet e

NATO-s; dhe një angazhim për marrëdhëniet demokratike civilo-ushtarake dhe strukturat institucionale.<sup>7</sup>

**29.** Studimi i vitit 1995 nënvizon rëndësinë e reformave demokratike dhe kështu zgjeron fushën e përqendrimit të Aleancave përtej çështjeve të sigurisë. Në praktikë, këto kërkesa ishin të vështira për t'u arritur nga vendet aspiruese të ish-Bllokut Lindor të cilat po kalonin një proces gjithëpërfshirës të reformave ekonomike, politike dhe ushtarake. Kështu, për të ofruar këshilla, ndihmë dhe mbështetje praktike, të përshtatura për nevojat individuale të vendeve që dëshirojnë të anëtarësohen në Aleancë, NATO lansoj në prill 1999 Planin e Veprimit për Anëtarësim (MAP).

**30.** Qëllimi kryesor i Planit është të ndihmojë vendet që aspirojnë anëtarësimin në NATO në përgatitjet e tyre dhe ajo u bazua shumë në përvojën e fituar gjatë procesit të pranimit të Republikës Çeke, Hungarisë dhe Polonisë, të cilat u bënë anëtare të raundit të parë të zgjerimit pas Luftës së Ftohtë në 1999.<sup>8</sup> Plani i Veprimit për Anëtarësim, i cili është një manifestim praktik i politikës së Dyerve të Hapura, është i ndarë në pesë kapituj: I. çështjet politike dhe ekonomike; II. çështjet e mbrojtjes / ushtarake; III. çështjet e burimeve; IV. çështjet e sigurisë; V. çështjet juridike.

**31.** Procesi i MAP siguron një mekanizëm të përqendruar dhe fer të vlerësimit mbi përparimin e vendeve aspirante në programet e tyre dhe përfshin këshilla politike dhe teknike. Një element kryesor është qasja e planifikimit të mbrojtjes për vendet që aspirojnë, e cila përfshin përpunimin dhe rishikimin e objektivave të planifikimit të rëna dakord. MAP ndihmoi në përgatitjen e shtatë vendeve që iu bashkuan NATO-s në raundin e dytë të zgjerimit pas Luftës së Ftohtë më 2004 (Bullgaria, Estonia, Letonia, Lituania, Rumania, Sllovakia dhe Sllovenia), si dhe Shqipëria dhe Kroacia (të cilat u bashkuan në prill 2009) dhe Mali i Zi (i cili u

---

<sup>7</sup> NATO (2019) 'Zgjerimi'. E disponueshme: [https://www.nato.int/cps/en/natohq/topics\\_49212.htm](https://www.nato.int/cps/en/natohq/topics_49212.htm) [Qasur më: 22 tetor 2019].

<sup>8</sup> NATO (2019), 'Plani i Veprimit për Anëtarësim (MAP)'. E disponueshme: [https://www.nato.int/cps/en/natolive/topics\\_37356.htm](https://www.nato.int/cps/en/natolive/topics_37356.htm) [Qasur më: 22 tetor 2019].

bashkua në 2017). Pjesëmarrësit aktualë në MAP janë Bosnja dhe Hercegovina dhe Republika e Maqedonisë së Veriut.

**32.** Një vështrim prapa në histori tregon qartë se suksesi në demokratizim ishte qartë faktori më i rëndësishëm në favor të përparimit të shteteve post-komuniste drejt anëtarësimit në NATO.<sup>9</sup> Për shembull, Polonia, Hungaria dhe Republika Çeke (dhe Sllovenia) ishin demokracitë e vetme të konsoliduara në Evropën post-komuniste kur NATO i ftoi ata të bashkoheshin me aleancën në Samitin e saj të Madridit në 1997. Vendeve tjera iu nevojiti më shumë kohë për të arritur demokracinë e konsoliduar dhe kontrollin demokratik civil mbi forcat e armatosura dhe kështu të hapnin dyert për anëtarësimin në NATO.

**33.** Me pak fjalë, sipas procedurave të NATO-s, një vend që shpreh interes për anëtarësimin në Aleancë fillimisht ftohet të përfshihet në një Dialog të Intensifikuar me NATO-n në lidhje me aspiratat e anëtarësimit të tij dhe reformat që lidhen me të. Vendet aspirante më pas mund të ftohen të marrin pjesë në MAP për t'u përgatitur për anëtarësim të mundshëm dhe të demonstrojnë aftësinë e tyre për të përmbushur detyrimet dhe angazhimet e anëtarësimit në të ardhmen. Pasi Aleatët kanë vendosur të ftojnë një vend të bëhet anëtar i NATO-s, ata zyrtarisht ftojnë vendin të fillojë bisedimet e pranimit me Aleancën. Ky është hapi i parë në procesin e pranimit në rrugën e anëtarësimit zyrtar.

**34.** Shpejtësia e pranimit ndryshon në mënyrë të konsiderueshme dhe varet nga aftësitë e vendeve individuale për të ndërmarrë reformat e nevojshme dhe për të përmbushur standardet e kërkuara. Për shembull, Bullgaria, Estonia, Letonia, Lituania, Rumania, Sllovakia dhe Sllovenia u bënë pjesë e MAP-it më 1999 dhe u bënë anëtare të NATO-s më 2004. Nga ana tjetër, Mali i Zi iu bashkua MAP në dhjetor 2009 dhe u bë anëtar i Aleancës në qershor 2017. Në rastin e Shqipërisë, vendit iu desh një dekadë për t'u bërë anëtare e NATO-s pasi ajo u bë pjesë e MAP më 1999.

---

<sup>9</sup> Zoltan Barany (2009), 'Shtrirja e ombrellës: Zgjerimi lindor i NATO-s.' *European View*, 8(2), 231–238, 233.

- 35.** Maqedonia e Veriut është një përjashtim i dukshëm. Ajo u bë pjesë e MAP më 1999 dhe ishte gati të pranonte një ftesë për të filluar bisedimet e pranimit në 2008 së bashku me Shqipërinë dhe Kroacinë, por Greqia përdori veton e saj për të bllokuar anëtarësimin e saj në NATO. Sidoqoftë, më 11 korrik 2018, pas marrëveshjes historike midis Athinës dhe Shkupit për zgjidhjen e çështjes së emrit, liderët aleatë ftuan qeverinë në Shkup të fillojë bisedimet e pranimit për t'u anëtarësuar në NATO. Maqedonia e Veriut do të bëhet shteti i 30-të anëtar i NATO-s.
- 36.** Rasti maqedon nxjerr në pah një çështje të rëndësishme në lidhje me anëtarësimin në NATO. Përkatësisht, parimi i vendimmarrjes njëzëri zbatohet për të ftuar vendet e reja për t'u anëtarësuar në Aleancë. Pra, megjithëse Maqedonia e Veriut kishte përmbushur të gjitha kriteret dhe ishte gati të fillonte bisedimet e pranimit më 2008, mosmarrëveshja e saj për emrin me Greqinë u bë një pengesë e pakapërcyeshme. Në rastin konkret të Kosovës, duke pasur parasysh që katër anëtarë të NATO-s (Spanja, Greqia, Sllovakia dhe Rumania) nuk e njohin Kosovën, një vendim për të filluar bisedime zyrtare të anëtarësimit është joreale nëse jo e pamundur për momentin.
- 37.** Në mënyrë të ngjashme, Qiproja mbetet e vetmja anëtare e BE-së që nuk është anëtare e NATO-s ose pjesë e një programi partneriteti. Kjo për shkak të refuzimit të Turqisë për të njohur autoritetet e Republikës së Qipros si përfaqësuesit e vetëm të ishullit të ndarë. Kjo jo vetëm që e ka penguar Qipron të bashkëpunojë më afër me NATO-n, por gjithashtu është bërë një pengesë në bashkëpunimin strategjik të NATO-s me BE-në.<sup>10</sup>
- 38.** Sidoqoftë, përveç anëtarësimit zyrtar, NATO ka zhvilluar një rrjet partneritetesh me rreth 40 vende jo-anëtare nga zona Euro-Atlantike, Mesdheu dhe rajoni i Gjirit, dhe partnerë të tjerë në të gjithë globin. Këto vende ndjekin dialog dhe bashkëpunim praktik me Aleancën dhe shumë prej tyre kontribuojnë në operacionet dhe misionet e udhëhequra nga NATO ndërkombëtarisht.

---

<sup>10</sup> Peter Ricketts (2019), 'Pse bashkëpunimi BE-NATO është provuar kaq i vështirë'. E disponueshme: <https://www.kcl.ac.uk/news/why-eu-nato-cooperation-has-proved-so-difficult> [Qasur më: 22 tetor 2019].

- 39.** Një program i tillë i partneritetit është Partneriteti për Paqen (PfP) i filluar më 1994. Ai është një program i bashkëpunimit praktik dypalësh midis vendeve individuale partnere euro-atlantike dhe NATO-s. Ky program i lejon partnerët të krijojnë një marrëdhënie individuale me NATO-n, duke zgjedhur përparësitë e tyre për bashkëpunim. Aktualisht, ka 21 vende (përfshirë Serbinë) në programin Partneritet për Paqen. Shumë vende pjesëmarrëse në këtë program zgjedhën të kontribuojnë me trupa në operacionet e ruajtjes së paqes të NATO-s në të gjithë botën. Për shembull, disa vende partnere të NATO-s kanë vendosur paqeruajtësit si pjesë e forcës paqeruajtëse të drejtuar nga NATO në Kosovë (KFOR).
- 40.** Një partneritet tjetër i rëndësishëm është Karta e Adriatikut, një nismë e formuar nga Shqipëria, Kroacia, Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Shtetet e Bashkuara për të ndihmuar përpjekjet e tyre për t'u anëtarësuar në NATO. Karta u nënshkrua më 2 maj 2003 në Tiranë nën kujdesin e Shteteve të Bashkuara. Bosnja dhe Hercegovina dhe Mali i Zi u bashkuan në vitin 2008. Kosova dhe Serbia janë vëzhgues që nga viti 2012. Kërkesa për anëtarësim e Kosovës në 2014 u refuzua për shkak të kundërshtimit nga Bosnja dhe Hercegovina.
- 41.** Si përmbledhje, politika e Portës së Hapur të NATO-s ka qenë qasja mbizotëruese pas rënies së komunizmit. Ndërsa misioni dhe vlerat themeluese të NATO-s janë akoma në fuqi, kërkesat dhe procedurat e anëtarësimit të tij janë modifikuar në dritën e ndryshimeve në kontekstin e pas Luftës së Ftohtë. Në praktikë, NATO është bërë një fuqi e madhe transformuese në Evropën Lindore.
- 42.** Për më tepër, marrëdhënia e ngushtë afatgjatë midis demokracive të Evropës dhe Amerikës së Veriut është mbështetur në vlera të përbashkëta, siç është fryma e lirisë individuale dhe bindja se qeveritë duhet të udhëhiqen nga parimi i sundimit të ligjit, mbrojtja e të drejtave të individëve dhe të pakicave, plus një gatishmëri për të bërë sakrifica për të mbrojtur këto vlera.<sup>11</sup>

---

<sup>11</sup> Lee Crowley, B. (2011), 'Marrëdhënia Transatlantike: Një Aleancë e vlerave.' *European View*, 10(1). E disponueshme: <https://journals.sagepub.com/doi/10.1007/s12290-011-0161-7> 121-126 [Qasur më: 22 tetor 2019].



- 43.** Tridhjetë vjet pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, është bërë e qartë se nuk ka asnjë alternative të vlefshme për ombrellën e sigurisë së NATO-s mbi Evropë. “Pjesa lindore e kontinentit po përballet me një Rusi revizioniste dhe ekspansioniste. Stabiliteti i tij mund të sigurohet vetëm nga një aleancë efektive që krijon baza të përhershme në rajonet më të prekshme si një parandalues për agresionin e Moskës. Një prani e fortë e SHBA-së brenda një aleance të gjerë që përfshin të gjitha demokracitë e Evropës është në interesin kombëtar të Amerikës dhe të të gjithë anëtarëve të NATO-s.”<sup>12</sup>
- 44.** Kërcënimi i ri i paraqitur nga një Rusi në ringjallje, si dhe akterë të tjerë me agjendat anti-evropiane dhe anti-demokratike, e bëjnë anëtarësimin në NATO gjithnjë e më të rëndësishëm për vendet e Ballkanit Perëndimor. Me një BE që lufton në betejën për tu reformuar ndërsa ruan unitetin, NATO është institucioni i vetëm i mbetur që mbështet sigurinë ndërkombëtare.
- 45.** Zgjerimi i NATO-s në Evropën post-komuniste është zhvilluar në mënyrë të barabartë, dhe në disa raste, i ka paraprirë procesit të evropianizimit. Ajo “ka siguruar bazën për një zgjerim të thelbit të shoqërisë ndërkombëtare evropiane pasi që anëtarët e rinj janë përfshirë në praktikën institucionale, politike dhe sociale të asocuara me Aleancën dhe NATO-n”.<sup>13</sup>
- 46.** Megjithatë, përkundër përfshirjes së drejtpërdrejtë të NATO-s për 20 vjet në Kosovë, Kosova ende nuk ka për të krijuar ndonjë marrëdhënie zyrtare, bilaterale ose kontraktuale me NATO-n. Më shumë se njëmbëdhjetë vjet nga shpallja e pavarësisë, Kosova ende mbetet i vetmi vend i Ballkanit Perëndimor që nuk ka asnjë formë të bashkëpunimit zyrtar me NATO-n. Në vijim, punimi vlerëson gjendjen në Kosovë në sektorin e sigurisë dhe marrëdhëniet e saj me NATO-n.

---

<sup>12</sup> Janusz Bugajski (2016), ‘Only Nato Can Defend Europe.’ *European View*, 15(1), 27–35, 27. E disponueshme: <https://journals.sagepub.com/doi/10.1007/s12290-016-0383-9> [Qasur më: 22 tetor 2019].

<sup>13</sup> Mark Webber (2011), ‘NATO: Brenda dhe në mes të Shoqërisë Ndërkombëtare Evropiane.’ *European Integration*, 33:2, 139-158, 154.

## Kosova dhe NATO: Një 'fëmijë' i NATO-s që trajtohet si i flakur

- 47.** Marrëdhëniet e Kosovës me NATO-n janë komplekse dhe paradoksale. Në shumë mënyra, Kosova i detyrohet Aleancës së NATO-s për ekzistencën dhe sigurinë e saj. Megjithatë, vendi është i vetmi në rajon pa asnjë lloj marrëdhënie bilaterale me NATO-n. Sado e mirëseardhur që është nga institucionet e Kosovës dhe njerëzit e saj, NATO është e pranishme në Kosovë jo si rezultat i një marrëveshje zyrtare me Kosovën por në bazë të një marrëveshje me një vend që nuk ekziston më - Republika Federale e Jugosllavisë (RFJ). Përkundër kësaj dhe ndryshimeve të tjera domethënëse që kanë ndodhur ndërkohë, më e rëndësishmja, shpallja e pavarësisë së Kosovës në 2008 dhe themelimi i Forcave të Armatosura të Kosovës në vitin 2018, mandati i NATO-s ende mbetet i njëjtë dhe buron nga Rezoluta 1244 e OKB-së.
- 48.** Legjislacioni kosovar përmban një numër klauzolash që riafirmojnë mandatin e NATO-s dhe synimin e Kosovës për t'u anëtarësuar në Aleancë. Nga njëra anë, vetë preambula e Kushtetutës kosovare pohon 'qëllimin e pjesëmarrjes së plotë të shtetit të Kosovës në proceset e integritetit euro-atlantik'.
- 49.** Nga ana tjetër, neni 153 [Prania Ndërkombëtare Ushtarake] e Kushtetutës së vitit 2008, përcaktoi se "Pavarësisht nga ndonjë dispozitë e kësaj Kushtetute, Prania Ndërkombëtare Ushtarake ka mandatin dhe kompetencat e përcaktuara në instrumentet përkatëse ndërkombëtare, përfshirë Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, të datës 26 mars 2007. Kreu i Prezencës Ushtarake Ndërkombëtare do të jetë, në përputhje me Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, datë 26 mars 2007, autoriteti përfundimtar në teatër në lidhje me interpretimin e atyre aspekteve të Marrëveshjes në fjalë që i referohen Pranisë Ushtarake Ndërkombëtare. Asnjë autoritet i Republikës së Kosovës nuk ka juridiksion të rishikojë, zvogëlojë ose kufizojë mandatin, kompetencat dhe detyrimet e përmendura në këtë nen."

50. Ky nen nen edhe mandatin e KFOR-it sipas Rezolutës 1244 dhe mungesën e juridiksionit të Kosovës për të rishikuar, zvogëluar ose kufizuar këtë mandat. Sidoqoftë, ky nen u shfuqizua<sup>14</sup> në vitin 2012 në fund të periudhës të pavarësisë së mbikëqyrur të Kosovës duke imponuar kështu nevojën për një kornizë të re që rregullon marrëdhëniet bilaterale ndërmjet Kosovës dhe NATO-s. Sidoqoftë, NATO deri më tani nuk ka treguar shenja ose gatishmëri për të negociuar një marrëveshje të re për praninë e saj në Kosovë dhe vazhdon të funksionojë sipas mandatit të saj original, megjithëse me angazhime të zvogëluara në terren. Të gjitha ndryshimet që kanë ndodhur deri më tani në lidhje me detyrat dhe përgjegjësitë e NATO-s janë ndërmarrë nga anëtarët e NATO-s pa konsultime zyrtare me autoritetet e Kosovës.

51. Megjithatë, si pjesë e procesit të marrjes gradualisht të më shumë përgjegjësi për sigurinë e saj, në mars 2012 Qeveria e Republikës së Kosovës filloi një Rishikim të Sektorit të Sigurisë Strategjike (SSSR).<sup>15</sup> Qëllimi i SSSR ishte të bënte një analizë gjithëpërfshirëse të të gjitha aspekteve të sigurisë në Republikën e Kosovës në mënyrë që të analizojë sfidat aktuale dhe të ardhshme të sigurisë; përcaktojë qartë rolet e secilit institucion në sektorin e sigurisë për të shmangur dublikimin dhe për të maksimalizuar aftësitë institucionale; dhe për të identifikuar aftësitë e kërkuara për të garantuar sigurinë e qytetarëve të Kosovës.

52. Megjithëse procesi SSSR ishte një proces serioz, metodik, analitik, i cili u zhvillua me sukses me qëllim që të siguroj një përgjigje ndaj nevojave të sigurisë në përputhje me aftësitë financiare, shumë nga rekomandimet e tij nuk janë zbatuar ose janë vonuar nga institucionet relevante.<sup>16</sup>

---

<sup>14</sup> *Ndryshimet në Kushtetutën e Republikës së Kosovës në lidhje me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës [Botuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës / Nr. 25/7 Shtator 2012, Prishtinë]*

<sup>15</sup> Qeveria e Kosovës (2014), 'Analiza e Rishikimit të Sektorit të Sigurisë Strategjike të Republikës së Kosovës'. E disponueshme: [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Analysis\\_of\\_Strategic\\_Security\\_Sector\\_Review\\_of\\_RKS\\_060314.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Analysis_of_Strategic_Security_Sector_Review_of_RKS_060314.pdf) [Qasur më: 22 tetor 2019].

